



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 840 Prot.

Tiranë, më 12 . 11 . 2024

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 110, datë 12 . 11 . 2024

“Për fillimin e mbikëqyrjes me objekt monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024”.

Në zbatim të nenit 11, pika 1, dhe nenit 14 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; të Planit vjetor të veprimtarisë së Komisionerit për vitin 2024, të miratuar me vendimin nr. 106, dt. 15.12.2023, të Komisionerit; si dhe të Rregullores “Për procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të ndryshuar, nisur nga problematika që kanë ngritur organet me kompetenca kontrolli, të brendshëm apo të jashtëm, në lidhje me respektimin e kërkesave të tyre për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të konstatuar me shkelje disiplinore, gjatë veprimtarisë së tyre,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore, me objekt: *zbatimin e detyrimit ligjor, që kanë organet disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024.*

2. Ky proces do të kryhet nga Inspektorët në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, të cilët do ta zhvillojnë këtë proces sipas ndarjes për institucionet e administratës shtetërore në vijim:

1. **Antea Kabali** - Këshilli i Ministrave dhe institucionet e varësisë
2. **Dorela Halilaj** - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësisë
3. **Elvis Qerimaj** - Ministria e Evropës dhe e Punëve të Jashme dhe institucionet e varësisë
4. **Behare Hoxha** - Ministria e Brendshme dhe institucionet e varësisë
5. **Ledina Zhupa** - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e varësisë
6. **Franceska Doksani** - Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë
7. **Zamira Mujali** - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë
8. **Alda Xhaxhiu** - Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe institucionet e varësisë
9. **Inesa Brokaj** - Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë
10. **Erion Mata** - Ministria e Financave dhe institucionet e varësisë
11. **Eros Hoxha** - Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e varësisë
12. **Granit Bajri** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë.

3. Mbledhja e informacionit do të realizohet nëpërmjet komunikimit zyrtar me njësitë përgjegjëse përkatëse, përmes shkresave zyrtare / e-mailit zyrtar, apo mjeteve të tjera ligjore të komunikimit, apo duke u paraqitur në institucion, sipas rastit, nëse është e nevojshme.

4. Ky proces do të fokusohet në zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë organet disiplinore, sidomos në rastet e kërkesave/raportimeve të dërguara nga ana e subjekteve të kontrollit të brendshëm ose të jashtëm, për të filluar ecuri disiplinore në ngarkim të personave përgjegjës. *(Të dhënat e adminitruara do të rakordohen me informacionin e ardhur nga institucionet si KLSH, Auditi i Brendshëm i institucioneve, e të tjera)*. Procesi do të orientohet në drejtimet e përcaktuara në programin e mbikëqyrjes, si dhe tabelën bashkëlidhur urdhërit.

5. Të dhënat e mbledhura do të përpunohen në vijimësi dhe do të raportohen në relacionin përkatës, nga ana e secilit inspektor. Situata e konstatuar do të administrohet në një raport vlerësimi, i cili do të miratohet nga ana e Komisionerit në përfundim të këtij procesi.

Mbikëqyrja do të shtrihet në kërkesat drejtuar institucioneve të përfshira në këtë urdhër, për vitin 2024.

6. Në rast se, në të dhënat e raportuara nga institucionet, të dërguara pranë Komisionerit, evidentohen parregullsi, situata do të verifikohet në vend në subjektin përkatës nga inspektori i ngarkuar, i cili do të pajiset me një autorizim të veçantë për këtë proces.

7. Për koordinimin dhe menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së orientuar për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, ngarkohet Drejtori i Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, i cili do të jetë përgjegjës për respektimin e afatit të raportimit; për administrimin e të gjitha akteve me të cilat do të raportojnë inspektorët dhe për përcjelljen e tyre pranë Drejtorit të Përgjithshëm, i cili do të marrë masat për të përgatitur raportin përfundimtar të vlerësimit, që do të miratohet nga Komisioneri në fund të vitit kalendarik.

8. Me këtë urdhër, duhet të njihen të gjithë inspektorët e ngarkuar për ndjekjen e procesit, duke i vënë në dispozicion një kopje të aktit si dhe programit të mbikëqyrjes.

9. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit; Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes; Drejtori i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ; Drejtori i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit dhe inspektorët përkatës, sipas pikës 2 të këtij urdhëri, si dhe Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetese, për të mbështetur procesin në drejtim të sigurimit të fondeve përkatëse dhe logjistikës.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

